



**BASHKIA E TIRANËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr.9 Datë 27.02.2015

**Për**

**“MIRATIMIN E DOKUMENTIT “PLANI I VEPRIMEVE PËR ENERGJINË E QËNDRUESHME TË TIRANËS ” PËR PROJEKTIN E “EFIÇENCËS SË ENERGJISË”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 10, pika 3, nenit 32, pika “k” dhe nenit 33, pika 2 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”(i ndryshuar), “Marrëveshjes së Kryebashkiakëve” nënshkruar në datë 29 Maj 2013 nga Kryetari i Bashkisë Tiranë në bazë të Memos Nr.956 datë 25.04.2014, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak, Tiranë:

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë dokumentin “Plani i Veprimeve për Energjinë e Qëndrueshme të Tiranës” të projektit të “Efiçencës së Energjisë”.
2. Të dorëzojë pranë Konventës së Kryetarëve sipas detyrimeve të përcaktuara në Marrëveshjen e Kryebashkiakëve raportin e zbatimit me planin e veprimeve monitoruese çdo 2 vjet pas miratimit dhe dorëzimit të SEAP-it.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Investimeve të Huaja, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Projekteve Strategjike, për monitorimin e zbatimit të PVEQ-së.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**ALDRIN DALIPI**